

Reshat Avdiu

LULËKUQET NË QELI



SHËNIME PËR AUTORIN

Reshat Avdiu u lind më 19 mars 1957 në fshatin Bushtran, komuna e Preshevës. Rrjedh nga një familje me tradita të lavdishme kombëtare, familje e shpërngulur me dhunë dhe terror nga trojet e veta të lashta nga Masurica e Kazasë së Vrajës gjatë viteve 1877-1878. Rashati kurrë nuk do të pajtohet as me atë politikë as me këtë të sotit që ka ende tendenca për t'i copëtuar tokat shqiptare për interesat e shteteve hegjemoniste ballkanike. Ai në të gjitha kohërat e ngriti zërin e protestës, zërin e arsyes dhe për këtë Organet policore serbiane e ndoqën, e arrestuan dhe për disa vite rresht e mbajtën në burgje të rënda, në burgje famkeqe të Serbisë si në Vrajë Leskoc, Beograd "CZ" e Pozharevc. Gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu shkroi poezi patriotike në të cilat pasqyron në formë artistike shpirtin e tij prej atdhetari dhe krijuesi të talentuar. Reshat Avdiu ka shkruar një monografi "Terrori serb ndaj shqiptarëve të Masuricës dhe Vrajës 1878-1999", e botuar në vitin 2006.

Vepra "Lulëkuqet në qeli" është vepra e parë artistike e tij.

Lektor dhe korrektor: Arta Këqiku
Redaktor: Hysen Këqiku
Recensues: Biladh Maliqi
Realizimi artistik i kopertinës: Florit Hoxha
Këtë libër e financoi: Burim Avdiu,- djali i autorit
Shtëpia botuese KURORA Gjilan,2006.

SHOKËVE NË QELI

Sa më dhembsesh o shpirt
i mbërthyer
në pranga e zinxhir
forca për ardhmërinë
nuk kërkon mëshirë.

Në agoni përqafohemi fort
Dëgjohen psherëtima
"Të mos ipemi shokë"
patundshmëria dhe qëndresa
shoqërohen në errësirën e qelisë

Plaga kullon gjak vëllau
Edhe atij i dhemb si mua
Në çdo përqafim bëjmë vëllamëri
Ashtu të dërmuar
Kthehemi në qeli...

Plaga në sakatosje
E ngushëllon vëllaun në gjak
-Po ndërrohet roja vëlla
Në plagë do të hapin plagë

Kurorëzuar jemi me qëndresë
Nga gjaku ynë
Liria më e ngrohtë
Do të jetë

("CZ", Beograd, 1983)

BETEJA E KAÇANIKUT

Ujë e gjak rrjedh
Lumi n'Kaçanik
Refren këngësh bëjnë
kanonadat e topave
flamuri ngjyrgjak
gërryen shekujt e robërisë
Idriz Seferi bashkon Sharr e Karadak

Derisa shtojzovallet
Thurrin parzmoren e Mic Sokolit
Çallmat me gjysmëhënë
E kanë marrë tatëpjetën
Besë e madhe më gjëmë shqiptare
I shumëzojnë çallmat mbi ujin gjak.

Maje minares në Kaçanik
Një arkitekt i robërisë osmane
Thërret ezan dhe nam
-Kaçanik të shitoftë shita
"Dymbëdhjetë sahat tue u pre me thika".

Sulltani në luksin e tij
Ëndërroi tek i shkëputej hëna
I ra në lumin e Kaçanikut
Bushtran 1990

ZHVARRIME NË DEMOKRACINË E SHIPËRISË

(Shokut Enver Hoxha)

Për "demokratët" e Shqipërisë
një varr
trupin Tënd dy o, Enver Shpati

Si Ali Pashë Tepelenës
Kokën në Stamboll
Trupin në Janinë
Kështu urdhëruan kozmopolitët
-"Demokratët" e ekzekutuan"-

Enver Hoxha –
Duhet t'i ketë dy varre –thanë
Një për Shqipërinë e "Okupuar"

-Uniteti në atë kohë i gjithë Shqipërisë
Ka qenë barrikada e mbarë Shqipërisë
Në të kokën e tyre e thyen
Kozmopolitët e sotëm.
-Manipulatorët e Shqipërisë

Bushtran 1992

TIVARIT

Po ecën Kosova
drejt mortjes
Valë të gjakut do të ngritën
në ty
Tivar
Kolona shqiptare ecën e s'ka të ndalë
Tradhtia është diku
mbi ty
Tivar
Ullinjtë me selvitë e gjata do të lahen
në gjak!
Komandanti do të futet me vetëdije
në tradhti
e hakë.
As deti as vala e jote e gjatë.
vështirë se do ta lajë
tradhtinë që u shkrua në ry

TIVAR

Bushtran 1995

BUSHTRANIT[1]

Më madhështor se i bukur
Me Kalanë e Ilirisë
Kush t'i zbuloj mrekullit
E shpirtit ilir

Sa është ngrohur bujaria ndër mote
Rreshkë malli për reliktet
E ndryshkur në shtresime

T'i Bushtrani ynë nuk u tunde,
Nga rrufetë e shekujve zbrazur në ty
Populli yt u martirizua;
barbarët këtë e bënë,
fluturimi i shqipes
Ende është i fortë
Mbi muret e larta
Këshqellë e Dardanisë.

Bushtan 1993

---

[1] ***Bushtrani i Vogël dhe i Madh, përshkruhen të jenë vendbanime në jug të Vrajës, ku në mënyrë direket janë në fqinjësi njëri pranë tjetrit. Në regjistrimin e vitit 1570, Bushtrani është quajtur BÜZÜK dhe është emërtuar si fshat në Moravë, ndërsa Bushtrani i Vogël si KÜÇÜK është emërtuar si Bushtran në Vrajë.***

NË KODRËN E KUQE
(Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazlisë)

Në Kodrën e Kuqe në kodrën e Madhe
Vijnë autoblinda me policë dhe tanke.
Shtrëngohet rrethimi – trimat po qëndrojnë,
Thirrjen për dorëzim ilegalët se pranojnë.

Kosovë, moj trime Prishtina jonë krenare.
Hapi sot portat Kosova jonë hallemadhe!
Janë bijtë e tu Kosovë moj martire,
Hasmi, barbar t'i ka marrë në nishan
Të lutem Kosova Nënë
çarën djemve ua bënë.

Në Kodrën e Kuqe në Kodrën e Madhe
Breshëri plumbash nga policia serbomadhe
Por edhe nga automatiku ilegal rafale !

Ilegalët, nuk ipen deri në fund qëndrojnë
Hallin e popullit të robëruar ata e kuptojnë!
Nata po afron, trimat po qëndrojnë
Fishekët i kanë nga fundi-ata prapë luftojnë!

Ju rriti Nëna o trima, Rinia jonë Kosovare
Me qumështin e saj e kishit pirë edhe hallin.
e robërisë shqiptare!

E honxho lonxhot, e tradhtisë së atëhershme
Kombëtare
Janë të njëjtit edhe sot disa nëpër
partitë kosovare!

Luajtën ata, me dekada të tëra
olo morto kombëtare.
Bërtisnin, atë mbrëmje se ua prishnin
Bashkëjetesën dhe rahatinë vëllazërore
Fisheku mbarohej s'kishin me ç'ka të

qëndrojnë!
Trimat plandosen – idealin në rini edhe më
tepër e shtojnë
Në terrin e Kosovës rini moj krenare
U ngritën dy
Yje, dy pishtarë në rrugën tuaj drejt lirisë.

Bushtran 1990

FAMILJEVE TONA

Para dyerve të Burgut në Vrajë
Presin të mërzitura familjet tona
të na vizitojnë.
Maltretohen e fyhen
në baza kombëtare.
Nga agjentë të tërbuar t'mizorisë
barbare!
Neve dhe ata me çdo – izma na
etiketojnë,
Tokat e *Stara Serbisë* [2] thonë:
Albanisë dojnë t'ia ribashkojnë.
A ka vëllezër, në botë dhembje
më të madhe,
Se kur fëmiu me dhunë ndahet
nga nëna!
E kjo ndarja jonë shqiptare;
Me dhunë e tradhti nga bota
E sotme barbare!
Ne nuk mërzitemi me gjepurat
e *Stara Serbisë.*
E duam fort Enverin e Shqipërisë
Se na përkrahë Ai gjithmonë në rrugën
e drejtë të pavarësisë

---

[2] Serbët e quanin Kosovën "Stara Srbija – Serbia e Vjetër!?

këtë poezi e shkrova pasi më kthyen nga burgu i "CZ" të Beogradit, në atë të Qarkut të Vrajës, gjatë shkurtit të vitit 1982.

PUNTORIA NË DEMOKRACI3[3]

Fjalë e modës demokracia
-Në praktikë e ka të ithët prapavijë
Ne punëtorët e mbarë botës e kuptuam
këtë frazë e shpikën
Ata që na shfrytëzuan
Pallate e fabrika gjithkund ndërtuam
Ndër podrume të errëta jetën e kaluam
Me djersën dhe gjakun tonë të mira
Prodhuam
Prapë si raste sociale nga tiranët u
trajtuam
Ka filluar punëtorë të fyej uragan i
Furisë
Së shpejti, punëtoria do të bëhet zot
i punës, i drejtësisë
Po tundet vëllezër tirania nga tërmeti
i proletariatit
Po shembet nga themeli klasa e
Shfrytëzuesit
dhe e pseudodemokratit

---

[3] *Kjo vjershë i kushtohet demonstratave të 1 Majit të vitit 1996, në: Stamboll, Berlin, Tokio, Paris, Romë etj. Ku pati shumë të vrarë dhe të plagosur nga radhët e proletariatit. Ishte përsëritur Çikagoja e SHBA-ve dhe Komuna e Parisit, të cilat u zhvilluan, mes policisë borgjeze dhe punëtorisë.*

ATYRE QË SHKUAN

Shqiptarë! Shumëkush nga ne fjalën e
Dhamë
Nëpër Kosovën e robëruar
betime bëmë!
Thamë të mos e lëshojmë pragun
e shtëpisë
Se ia kënaqim shpirtin dushmanit[4]
t'shqiptarisë

Ne këtë nuk e bëmë vëllezër shqiptarë
Shkuam gjithkund anë e mbanë
Kosova sot mbet e mjerë pa djemtë e saj

E plandosur për tokë
E mbushur në vaj
Ajo nuk ka sot nevojë për çmime
NOB për paqë
As për konferenca shterpe
nga Fuqitë e Mëdha
Vaji i saj është për djemtë që i shkuan
e nuk i ka më
Kthehuni vëllezër Kosova ju pret

Çmimi i lumturisë është në gjakun tonë

Bushtran, 1991.

DRIDHESHE NË ATË MËNGJES

Nder ara e livadhe agimet zbardhin
Selo, fshatari ynë – mundi
i agimeve të bardha
Në pranverë rreshta duhani mbjell

---

[4] **Dushman (tr) – armik-u**

-Mundi yt rrëke të shkon
Punën tënde të rëndë se vlerëson dot kush

Për çdo motmot të shohim pranë Monopolit të Duhanit[5]
të shohim për ç'do motmot.
Zemra të rrahë vrullshëm sytë i ke plot
me lot
Dridheshe në atë mëngjes dimëror
Gjaku të ngritët dallgë
Vlerësimin se bëjnë mirë të urryerit e
mundit tonë.
Mbrëmja po afron, në shtëpi ke ardhur

S'të pyet kush për duhanin
këtë mundin tonë
Pamjen e ke të zymtë ç'do anëtar e
kupton

Se duhani nuk shkoi mirë
Selo, ky mundi jonë

Bushtran 1996

P.S- i dashur lexues shumë anëtarë të familjeve në Kosovën Lindore që merreshin me kultivimin e kësaj bime industriale sëmureshin nga DBC (veremi), se vet duhani ka rrezatim që i sulmonte mushkëritë. Dhe se sanatoriumi i Surdulicës ishte ngritur enkas për shqiptarët tuberant të sëmurë nga veremi.

NË QELINË E BURGUT

Këtu, në qelinë e burgut nuk na japin
asgjë të lexojmë
Me shokët e kemi vështirë të
Komunikojmë

---

[5] **Vendi ku grumbullohej duhani i tharë nga prodhuesit**

Jemi të dënuar
Nuk i përfillmi urdhëratë e personelit
Nata dhe dita këtu fare s'figurojnë
Nëpër qeli
Janë të bëra
Në një tog
Vështirë, se ndokush ato dallon
Hapat ç'do ditë bëhen kilometra
Janë rrugët e gjata të të burgosurve
Për liri.
Diku nga sfondi i qelisë dhe errësirës
Dëgjoj trokitjet
" Të mbahemi shok e të mos dorëzohem
Dëshira e personelit të burgut të mos
Aprovohet"
Një ditë medoemos do të na lirojnë
Llapjani e drenicasi ia marrin këngës
Tradicionalisht Shqip
"Në Vraninë Oso Kukë Shkodrani
E mbushi truallin me varre të barbarit"

E shkruar në muret e burgut në qelinë nr. 4, në Pozharev më 1984

HOVET TONA REVOLUCIONARE

Hovi ynë rinor
Hovi ynë i parë
Të ëndërronim Kosovë e Kuqe.

Kur pas, ç'do beteje
I konsolidonim forcat

Nuk lodheshe Nënë e dashur
T'na ndihmojë.

Zërin Ti e ngritje

zërin për komplote,
të reja në robërim!

Kur na burgosnin e martirizonin,

Zërin e ngritnit
barbarit
i thoshe.

-Mos e hidhëroni shqiptarin
-Do marrë zjarr edhe stralli!

Këtë vjershë e pata shkruar në njërën
Nga
Muret e qelisë nr. 4 të Pozharevcit më
1984.
Ne pavijonin e shtatë (sedmakut)
E shkruar në Burgun e Vrajës, 1982.

ZIKORBA U VRA
(Avni Rrustemit)

Nëpër Parisin madhështor
në metropolin e Evropës
në *Kontinetal* mjaft bëre plane
për Esat Pashanë
Ai nëpër konferenca kërkon "ndihma"
Nga fuqitë e mëdha
D j a l o
- Që ta copëtojë edhe më tepër Shqipërinë

E nga malet Bacë Bajrami të çon të fala
shtrëngoje Avnioo nagantin
Se arriti sot ora e madhe e historisë

sot Pashanë do ta mbulojë D j a l o o
turpi i tradhtisë!
Avni trimi
Lëvdatë e përmotshme,
E mbarë Shqipërisë!
Parisi e Robespjeri bëjnë sehir Avnioo
vrasjen e Pashait!
Nga kodrinat e Belvildit, nga varret
Thërrasin komunarët
Zikorba
U vra, u vra

Bushtran 1999

POPULLIT HEROIK KURD

U tërbua bota demokratike
imperialiste
U çuan në këmbë
me topa,
raketa
autoblinda
thika
Si ujqër të uritur mbi kurdët
Thanë se janë
të kuq e
"barbarë"
Do të na i marrin fabrikat e kapitalin
Mbarë
Dhanë urdhër, të vriten të gjithë kurdët
Vërsulen kolona të gjata
Autoblinda, me topa pas
S'trembet populli kurd nga imperialistët
Në anën e saj e ka botën përparimtare

E Tansua Çileri me kamarillën e saj
Diku në Stamboll në Pallat

I bënë planet e saj karakurva për ç'farosjen
e kurdëve në masë
e nami i tyre
bëhet barrikada, ku do ta thyejnë
kokën e tyre
këmishëzinjtë e botës grabitqare

PA TY

(Arben Preshevës)[6]
Pa ty, Arben Presheva komisar
i kuq i dritës
Komandat partizan
në frontet e gjata të pritës
Për ty o, Arben Presheva thonë

Shumë herë u shkrua tradhtia

Pa ty o Arben Presheva
-na u nda Shqiptaria
Tradhtinë komandantët e shkruan
Ata puthadorët e urryer

Bushtran 1995

KALAJA ILIRE E BUSHTRANIT

Gjunjëzuar qëndroj para teje Kala e Bushtranit
Ta kujtoj dhe kremtoj tremijë vjetorin
Në çdo rresht të gurëve
Ruhet pika e gjakut e mjeshtrit ilir
Rreth teje shtrihej qyteti dardan

---

[6] **Arben Presheva përkatësisht Abdullah Krasniqi**

Turku e quajti Bushtran
Gradishte në sllavisht
Kroi i Kalasë me ujë të kristaltë
Dikur ujë në ty kanë pirë
mbretër ilir
komandant
e ushtarë.
Ti kujtoj
Ritualet-të bëra,
në gjuhën e Zotit
të Ilirisë.
Të mbirë nga ky troll i stërlashtë gjatë
historisë!
Kisha jote tempull i Zotit
të Dardanisë
përkulem para teje
do të ta shprehë një ndjenjë dhembshurie
korbazinjtë karpatianë
me të zezën këmishë
krrakatin në ty o kishë

Bushtran 1992.

Kalaja dhe Gradishta e Bushtranit janë vendbanime Iliro-Dardane të Antikës së lashtë, të kohës së hershme të Neolitit të shekullit të VI-II. p. e.

NË MJERGULLËN E DENDUR TË D E M O K R A C S Ë

Sot kudo o vëlla
o shok
o mik
i shoh qëllimet
-E gënjeshtrës të demokracisë
Premtime shterpe "për të drejtat e

njerëzisë
Nga ana tjetër ka vetëm shtypje dhe
Shfrytëzim
Luftëra të përgjakshme për tregje e
Kolonizim

Ty o shok,
I prangave të robërisë shqiptare
Të lutem pështyje këtë rend dhe jetë të
barbarisë.
Një ditë ka për të ardhur ai rend i
i vërtetë demokratik
pa diktate
fyerje
zinxhirë e kamxhik!

Lloji i punëtorisë do të bëhet një ditë;
Shembull i vetëvendosjes - lirisë

Bushtran 1999

ENVER HOXHA NË MOSKË

Vitet gjashtëdhjetë e një

Dimër i vogël apo i madh,
(Për atë kohë s'kishte shumë rëndësi)
Enver Hoxha do të shkonte në Moskë

Ta thotë fjalën e tij, fjalën e mbarë
Shqipërisë
Në emër të tetëdhjetë e një partive

Hrushqovi ishte bërë vrer,

Diku në sallë Kaganoviqit

i zihej
fryma
Moska e Hrushqovit të Rusisë;
Tentonte t'i hapte portat e Këshqellës
së Shqipërisë
Njet Gaspadar Tavarishi Risisë,

-Nuk hapen lehtë portat e Këshqellës
së Shqipërisë.

I ka mbyllur me dorën e vetë.
Me shpata dhe topa të rëndë
Zoti i vet Shqipërisë.

Bushtran 1996

S'ka më shqiptarë si Enver trimi që t'i dalë në mbrojtje Shqipërisë së shkretë sot shumë laro dhe bashibozuk tjerë po e shkelin dhe turpërojnë Zonjën e Madhe të Jonit dhe Adriatikut shqiptarë.

UÇK

Trima të Ushtrisë Çlirimtare
Bijtë e Kosovës sonë hallemadhe,
nëpër burgje
në pranga
flakë
e barot!
Po lahet
Kosova si gjithmonë
në lot e gjak!

Po i hapen asaj plagë të rënda në shtatë
Këtë herë vështirë se do t'i shërohen
Me shekuj që do t'i vijnë pas!

E bacë Bajrami
nga Alpet e Dragobisë
i çon të fala djemve të UÇK-ës
Me pushkët tuaja
O bijtë e Shqipërisë
Po e çoni në vend amanetin
e dëshmorëve,
të lirisë.

Bushtran 1998

E KISHIM BËRË BETIMIN
(Kadri Zekës)

Kur në Kosovën e robëruar atëherë
edhe sot
Robëria shtrëngohej ditë e natë
Mblidheshim
Shokët e t'u
të ilegales
netëve të vona
anë e mbanë Kosovës

Hallin e qanim mes veti
-Robërisë si t'ia bënim he burrë

E qentë besnik të regjimit
Na gjurmonin në ç'do skutë
të na zbulonin e ndëshkonin
për vepra penale ndaj
"Bratsvo Jedinstvos."[7]

---

[7] **Të "Vëllazërim bashkimit"**

-Ne nuk mërziteshim or vëlla Kadri
E kishim bërë betimin
Në flamur
"JA VDEKJE JA LIRI"

Bushtran 1992.

YLLI QË NUK FIKET KURRË

Ç'farë të keqeje u bëri
Ylli në flamurë
O, ju të
"bekuar të demokracisë"

Gjaku i 28 mijë
yjeve të lirisë
E vulosi
Yllin në flamurë

Të mos shuhet kurrë
Të qëndrojë gjithmonë mbi kokën
E shqipes aty në flamur

Me tetëorshin e kërkuar
Gjakuam për këtë yll të na e forcojë
shpirtin
Të na e bashkojë qëllimin

Ne punëtorët s'kemi atdhe
Globi Tokësorë me yllin në
Flamur,
Është atdheu ynë që nuk shuhet
Kurrë

Bushtran 1 maj 1994.

AGIME MËNGJEZORE

Mjegull e hollë mbi atdhe
Nata në shtrat gjumi shtrirë
Avujt e dendur nëpër fusha
Si orteqe të borës
Qëndrojnë
Këngëtarët e agimeve të bardha
Këngën kompozojnë
Nga kurorat e maleve
Drita sfidon mjegullën
Dialektikë është kjo
e botës sonë
Mullirit të vjetër kënga
s'i shterron
Nata do të ikë
Dita po afron
Dielli
-Ah dielli
Së shpejti do të lindë

Dielli së shpejti do të,
lindë-Liria

Bushtran më, 1996.

TË TËRHIQNIN TY!

(Obdullah Oxhalanit)

Të pamë
O shokë
O vëlla
O mik
Lidhur në pranga e zinxhirë
Me kapelën e zezë të mortjes
Të rrasur deri në fytyrë

Sfidoje djegien
fyerjen
skllavërinë
Sikur Dimitrovi para gjyqit fashist
në Lajpcig

S'kishe ndërmend të kërkoje
mëshirë
Të tërhiqnin Ty
Për pranga, e zinxhirë
Këta të Stambollit
fashistët e rinjë

Bushtran, 1999

E DESHE KËTË TOKË

(Xhevat Ajvazit)

E deshe këtë tokë
Të rimun në lot e gjak
Torturat e shovinistëve barbarë
Nuk të mposhtën jo, aspak

Rrugët e gjata t'ilegalës
Me shokët që u vranë
E lanë me gjakun e tyre
Këtë tokën tonë të shenjtë

Gjithmonë thoshe
Vetëm me guxim dhe trimëri
Kosova do të shkundet nga terri
Do ta fitojë të shtrenjtën l i l r i
-Moravica t'i ruan kujtimet
ndër shekuj
Për këtë tokë të lashtë

Shoku Xhevat!
Hekurudha s'mundi kurrë
ta bartë amanetin
e t'parëve tanë

Ata
Luftuan
me heroizëm
e trimëri
Eh shqipja
Sahelë u lëshua
me furi
nga Karadaku
Drejt kufirit
të sajë
etnik
ne Malin Rujan

Në ballafaqim në "Gjykatën e Qarkut të Vrajës" në prill të vitit 1982. Mua dhe Xhevatin na lidhën me zinxhirë njërin për një radiator dhe tjetrin për radiatorin tjetër derisa gjykatësi hetues na i muar deklaratat mbi punën tonë ilegale. Pasi që gjykatësi doli nga zyra UDB-shët, filluan të na torturonin pamëshirë me shufra gome dhe bishta të drunjtë. Nga goditjet e pandërprera filloi të na rridhte gjak. Nga ne kërkohej të tregonim për shokët dhe bazat tona ilegale në komunën e Bujanocit dhe Preshevës. Dhe përse Xhevat Ajvazi i paska nxitur shkollarët e Bujanocës që nëpër klasa ta shkruanin sloganin: "Fluturo dallëndyshe fluturo kah Shqipëria". Një UDB-shë, serb filloi ta godiste Xhevatin me një bisht nga mundte duke na e sha Shqipërinë dhe Enver Hoxhën. Si duket nga goditjet e pa mëshirshme Xhevatit ja thyen unazat e boshtit kurrizor edhe pas daljes nga burgu gjithmonë ka vuajtur deri sa vdiq nga torturat dhe kushtet e rënda nëpër kazamatet Jugosllave.

Bushtran 1993.

PRANGAT DO TË KËPUTEN
(MINATORËVE TË TREPÇËS)

Dëgjo fjalën e minatorit me FAT
Përshëndetjet tungjatjeta vëlla, a u lodhe
Kryeminatori plak vallë ku treti
-Shëtit rrugët e Europës, si njeri i mjerë
E nëpër vesh fjala si refren i shkon
-A ka punë zotëri
o, njeri i Europës
na u këput shpirti ynë i drobitur
Duke vizituar byrot nëpër Europë

Na përzunë nga minierat tona krajlt[8] , e Serbisë
Të përkrahur dhe shtytur nga kozmopolitët
e "demokracisë"

Dëbora e ka mbuluar Shalën e Bajgorës
Mjegulla e dendur, shtrihet mbi Kosovë

Prangat e robërisë shtrëngohen
ditë e natë
Forca e minatorit nuk shterron
Prangat do t'i këpusë nga çasti, në çastë
Me FAT minator
flamuri i kuq, po ngritet
Lartë e më lartë, atje mbi sfond po shembet
Robëria
Së shpejti minator, do të lindë l i r i a

Bushtran 1993.

---

[8] **Krajlët, kralët, ser. -mbret**

PUNTORES MEJREME

Motër e yllit mëngjesor
E bija e Afërditës – shqiptare
Herët e hoqe ferexhenë
Punëtorja e Monopolit të Preshevës
Mejremja jonë proletare

Të shihja ç'do mëngjes në rresht
Pranë Monopolit të Duhanit
Tek i renditje, fletët e verdha
mundqarja jonë preshevare

Sot këtu pranë mureve të Çanakalasë
Të mendoja ty dhe mundin tënd
Ti rron tok me brengat e popullit tonë

Ferexheja e UDB-së shtrëngon prangat
Thurrë rrjetë robërie tok me merimangat

Motër e yllit mëngjesor
E bija e Afërditës – shqiptare

Pozharev, burg, 1983

BESË BETIM MBI FLAMUR

(ADEM JASHARIT)

E zhveshe shpatën shqiptarisht
si rrufeja kur bie mbi male
I këpute
I këpute
Prangat e robërisë
barbare
Shqiptarët e pavdekshëm

Ua shndrite
dëshmorëve të rënë
Ti nuk vdes, o trim
O Komandat
Përgjithmonë
Nënave ofshamë gjata
Shaminë e zezë ua hoqe
Kosovës dhe Drenicës
Trimërinë amanet
besë e betim
mbi flamur

Preshevë, 1999

BURG E ROBËRI NA SHKOI JETA

I. (Në Burgun e Vrajës,1982)
Ndërsa nata vazhdon rrugën e errësirës
Ilegalët janë zgjuar
Në punën e tyre thundrrohet vendosmëria
Traktet zbardhin rrugëve mbi mure
-Dëshmojnë trimëri

Porosinë nesër, do ta kuptojë populli
Armën miken time
e shtrëngoj fort, si në përqafim
ngutemi me shokun e ilegales
nata është në mbarim

Na kanë rënë në gjurmë
tentojnë të na kapin

U mungon dioptria
Zotërinj të kolltuqeve
-Lëvizjes për liri kurrë s'mund t'ia ndalni
hapin

nata mbi reliefin ronitur
Ecim me traktet e ngjeshura
Tok me porosinë e Zotit Bind
Në horizontin e kuqëluar
Një flakadan i kuq
si zjarr po lind
II.
Shokët e ilegales mbi supe
bartin një dashuri
Të lidhur për një flamur
Besë e shqiptari
Kosova do të bashkohet me Nënën
-Ja vdekje ja liri

III.
Ndër prangat dhe grilat e burgut të zi,
Forcohet shpirti
Kalitet vendosmëria
Për luftëra të reja
Për liri.
Torturat ditë e natë vazhdojnë
Ne nuk ipemi
Të pamposhtur qëndrojmë!.
Na e shajnë
Kombin
Enverin
Shqipërinë
Ne prapë nuk flasim
Sillen mandej me lajka e mashtrim.
-Jemi të rinjë duhet të shprehni pendim...

Prapë nuk flasim
Tërbohen UDB-ashët[9] ,kolaboracionistët,
Torturat s'kanë mbarim

---

[9] Punëtorët e Sigurimit të Brendshëm Shtetëror

NË SANATORIUM

Ti sot punëtorja Mejreme në sanatorium
Dhimbjet përballon,
Sëmundja tinëzare shëndetin ta
rëndon.
Në Karadak nga vendlindja jonë
Shqipemalet lartësitë sfidojnë

Agimi i kuq po lind
-Drita po agon
Hijezezat po tërhiqen
-Atdheu hijeshon

Po duket mundqarja ime
liria së shpejti
do të lindë
E ti larg në këtë sanatorium
Mbshqellur në zi
E lodhur nga sëmundja
E fortë në krenari

Mundeqarja Preshevare nuk lindëm
sa për të vdekur,
sfiduam ndër shekuj të pa mposhtur
nën pranga të robërisë[10].

NGRITUNI

Zemra po na ndizet
Vrullshëm se ç'troket
Me fuqi orteku
Me kushtrim buçet

---

[10]. Nish, 1992, Derisa unë isha në Burg të Nishit, gruaja ime, Mirfanja e papërkulur (nga Garja e Karadaket të Preshevës), ishte shtrirë në sanatorium për t'u shëruar nga sëmundja e kancerit.

Ora po bie
Kush të mos presë
Në frontet e luftës
Çdo njëri t'zbresë

Gjaku e djersa juaj
Shumë lirë shitet në treg
Shfrytëzuesit me paratë tuaja
Në rrafsh shtëpiat si breg

Dardhishtë-Kosovë, 2003

28 NËTORI
-LUGINA TË ÇON TË FALA

Nëpër fusha kodra e male
Në Luginë të Preshevës prapë këndohet
kënga çlirimtare
Atje poshtë, në kufirin etnik shqiptar në
Ristovc
Të fala nga Lugina iu sjellin, prapë për
28 nëtor
Bijtë tanë të UÇPMB-së të rënë dëshmorë
Në Shkup, në Iliridë, atje te Ura e Gurit
Shaip Mustafa, me grusht luan gurin
Për luftërat e UÇK-së të Iliridës e ngritë
përsëri flamurin
atje nga Çamëria në Kala të Janinës
për brenda
Ali Pashë Tepelenës,
I rrahin shtatë zemra
Në Malësinë e Madhe Dedë Gjo Luli
Me serbo-malaziasit shteg më shteg
Në maje te Beçiqit shekujt e robërisë

Në flakë e barot i djegë
Shqipëri! Kosova bija yte e madhe
Do ti ribashkojë për jetë e mot tokat,
Shqiptare!
Dhe për ç'do 28 nëntor, në fushën e orës
së madhe
Ne shqiptarët të ribashkuar me shtetin tonë
Do të hedhim valle gjithëkombëtare
Shqiptare

RAPSODI KOHËS
1877-1878

I

Heu Kali i Trojës, përsëri se ç'na u ringjallë
Vrapon e vrapon ai nëpër Toplicë deri n'Tupallë

Frikë e t'merr ndër muhaxhiri varg e varg,
Vret pa mëshirë gra, pleqë e fëmijë he koftë larg.

Varre masive, në Nish, Leskoc, Vrajë, Kurshumli
Nishava e Vërlla, gjakun s'munden për ta pi'

Lot të përgjakur ato derdhin sot
Ku është bota humane t'vërtetën pse se thotë.

Golgota shqiptare, ecën nëpër dimër e acar
Me trupa të shkallmuar, me gjak të tyre larë.

Nënat shqiptare i shtrëngojnë fëmijët e ngrirë
Rrethuar me vojnika[11], veshur me pancir.

Rruga e muhaxherisë, është e gjatë, e pambarim
Rrugë e pafatësisë, rrugë e pa shpëtim.

---

[11] **Vonik, ushtar serb**

Përgjatë Moravës, murana po na mbijnë!
E kali i Trojës, trokun nuk po e ndalë, vetëm;
Hingëllinë.

II
Sanxhaku i Nishit, gjithkund në flakë e tym,
Vaje për shqiptari.
Vargmalet e Dardaneleve, seç janë mbushur,
përplot muhaxhiri!

Vaporët moskovit, bartin shqiptarë,
nëpër Detin e Zi.
Gra, pleq e fëmijë, vdesin nëpër vapore nga;
e zeza uri!

Në ujë deti i hodhën kufomat e Muhaxherisë
Shumë pakë arritën në tokën e Anadollisë.

Shënim:

Vitet 1877-1878 për shqiptarët etnik të Toplicës, Sanxhakut të Nishit, Leskocit, Kurshumlisë dhe të Vrajës ishin shumë të kobshme dhe fatzeza përkatësisht të barabarta me shfarosje masive.

Në këto dy vite u zhvilluan luftëra të rrepta në mes ushtrisë turke dhe asaj serbo ruse, në të cilën elementi shqiptarë u luftua më shumë se ai turk.

Të gjithë ato ngjarje makabre për shqiptarët etnik u zhvilluan para Kongresit të berlinit të vitit 1878.

Për zbrazjen e këtyre territoreve gjeografike me mbi 700 fshatra me shumicë të popullatës shqiptare, u lidhën dy marrëveshje një në mes Turqisë dhe Rusisë që me anijet e tyre t'i bartnin shqiptarët e nxjerrë me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe një në mes Turqisë dhe Serbisë së Millan Obrenoviqit që t'i pranojë familjet shqiptare që Serbia i quante turq. Qëllimi i Serbisë dhe i Rusisë ishte që të bëhej spastrimi etnik i kësaj pjese e jo të "shpëtohej ajo popullatë e terrorizuar dhe e masakruar. M'u për këtë arsye anijet e stërngarkuara me muhaxhirë shqiptarë ngadalësonin udhëtimin me qëllim që shumica e tyre të vdisnin gjatë rrugëtimit nëpërmjet Detin të Zi. Për shkak të ngadalësimit të udhëtimit ata mbetën pa ushqim dhe ujë të pijshëm dhe, një numër i madh i tyre vdiqën nga etja, uria dhe sëmundjet e ndryshme për shkak të kushteve të vështira të udhëtimit dhe atyre higjienike. Një numër i konsideruar i

muhaxhirëve ia mësyen Kosovës, ku sot ekzistojnë mijëra familje nga këto vise edhe sot i ruajn emrat e vendeve nga kanë ardhur për mbiemra.

E tërë kjo golgotë e shqiptarëve të Toplicës, Pusta Rekës e të Sanxhakut të Nishit, Leskocit, Vrajës, Kurshumlisë etj. janë pasqyruar në veprat e Sabit Ukës dhe në veprën time "Terrori serb ndaj shqiptarëve të Masuricës dhe të Vrajës 1878-1999" e botuar në vitin 2006.

M A S U R I C Ë S

I

Mbi fusha e male shtrihesh, o vendi
i stërgjyshit tim.
Rreth teje, o Masurica ime ngritën
malet me plot gjelbërim.

Përmes teje qetas ndër shekuj, Vërlla
ujë e lot pikon.
Poshtë teje mulliri i vjetër, ndër vite
etapat e robërisë numëron!

Për masuricasit që me kohë dhunshëm,
nga shtëpitë e tyre mërguar!
Shëtisin ata shkretirave t'Anadollisë
si arnaut të mallkuar.

Shtëpitë, arat, livadhet e malet
sot kanë mbetur shkretë.
Bisha karpatjane
I shfrytëzon dhe i pretë.

Kjo zemra ime e vuajtur kah mot,
Sot pikon helm e gjak.
Për fëmijët dhe vashat e Masuricës
Që na i preu shkau mu në prag.

II

E Qaniu, stërnipi i Jakupit – makinën nget
Drejt Masuricës me furi.
-Ku po shkojmë djalo – e pyes me lot në sy
-Në Masuricë t'stërgjyshit, në shtëpinë e tij

Tek varret e të parëve tanë ku pushojnë qetë,
Ndër dëllinja dhe lisa.
Lumin e Masuricës ta pyes- a bajti shumë
Gjakë shqiptari me plisa.

Ti varri dhe shtëpia e djegur
E stërgjyshit tim
O Masurica e lashtë
O vrragë e shpirtit tim.

Shënim: vështirë është për një ish të burgosur që lufton për një Shqipëri Unike, që të shkojë e t'i vizitoj vendet e të parëve tanë. Të cilët, nga dhuna dhe reprezaljet e ushtrisë vrastare dhe piromane të kryesodomostit atëbotë të Millan Obrenoviqit që dëshironte Serbinë ta shndërronte në shtet një nacional serb i kishte dëbuar të 714 fshatra shqiptare nga Toplica e Sanxhakut të Nishit dhe nga Qarku i Vrajës dhe atë me rreth 813.000 banor të saj autokton. Nëpër atë dimër dhe acar të madh, ku bora e kalonte trashësinë e sajë mbi një metër e më tepër, temperaturat kishin zbritur shumë nën zerro saqë druajt kishin filluar të pëlcitnin nga acari gjatë netëve si të çaheshin me sëpatë. Nënave muhaxhire, do t'u ngriheshin fëmijët e tyre në krahë se duhej ikur pa arritur ushtria e shkaut dhe ajo e rusit nëpër trojet tona etnike të Shën Konstantinit nga Naissusi që sundoi në Dardani nga vitet 306-337 të erës sonë. Dëbime këto, do të ishin nga Lugina e Krushevcit e deri në Luginën e Vrajës, Fuqitë e Mëdha Europiane nëpër marrëveshjet dhe kongreset e tyre deri nga korriku i viti 1878 do ta shkelnin në mënyrë më brutale integritetin dhe sovranitetin e Territorit Shqiptar. rreth 130.000 km2 të territorit tonë shqiptarë do t'i shkëputeshin, ku mandej do t'i anketoheshin Serbisë vasales Ruse. Nga ky moment do të fillonte, ndarja e tokave shqiptare për t'i kënaqur orekset e pa ngopura të Fuqive të Mëdha. Dhe se territoret tona do të shndërroheshin në plaçka tregu për kusuritjen e pazareve të tyre. Shkurt i ndanin tokat e Shqipërisë për t'i kënaqur dhe mbajtur këlyshët e Rusisë, bishat e egra e të pa civilizuar të sllavëve të Jugut dhe të Lindjes.

MASURICË, 26.XI.2003